

FJALA E DEPUTETES ZHENI GJERGJI

E ENJTE 21 PRILL 2022

E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë,

E nderuar zonja Ministre,

Ju bëtë një tablo shumë të mirë të arritjeve të shëndetësisë në Shqipëri. Ne nuk kishim ardhur këtu për të dëgjuar të gjitha arritjet, megjithatë, shëndetësia ka shumë për të bërë dhe ata që e ndiejnë më shumë janë shqiptarët. E vërteta dhe realiteti janë aty. Ajo që duhet përshëndetur në të gjitha këto që ju keni bërë është ekipi shëndetësor, i cili u prin të gjitha arritjeve të mëdha që ka qeveria "Rama", ai ekip mjekësh që punojnë pa pushuar ditë e natë në shërbim të popullatës shqiptare me një pagesë shumë të vogël dhe që sot janë të detyruar të marrin rrugët e Europës duke braktisur vendin. Kështu që, krahas arritjeve, ju lutem, bëni të mundur që mjekët të ndihen të respektuar aty ku punojnë.

Gjithsesi, sot ne jemi mbledhur sërish për të diskutuar dhe marrë në shqyrtim aktin normativ nr. 6, datë 18.03.2022 "Për miratimin e disa ndryshimeve të nënshkuara, amendimi i tretë, në marrëveshjen për prodhimin dhe furnizimin nga/dhe ndërmjet Pfizer Export B.V. dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, Ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, miratuar me aktin normativ nr. 3, datë 18.01.2021, të Këshillit të Ministrave" të ndryshuar". Qëllimi i këtij akti është miratimi i disa ndryshimeve në marrëveshjen me kompaninë Pfizer, të cilat do të mundësojnë blerjen e dozave për vitin 2022. Shqipëria, krahasuar me disa nga vendet e rajonit, e nisi me shumë vonesë, në datën 11 janar 2021, fushatën e vaksinimit anti-Covid "Shqipëria buzëqesh". Në fakt, qeveria gjithmonë zgjedh emërtime emocionuese dhe përfshirëse sa herë vendi gjendet para një vështirësie, qoftë kjo fatkeqësi natyrore, qoftë kjo krizë ekonomike apo politike, e shkaktuar nga vetë ajo.

Shqiptarët, në fakt, e paguan shumë shtrenjtë përballjen me Covid-19, por atyre nuk u buzëqeshi fati. Gjatë vitit 2021-2022 ka pasur mbi 15 mijë ndërrime jete shtesë, krahasuar me ato të vitit 2015-2019, ndërkohë që ndërrime jete nga Covid-19, të raportuara zyrtarisht nga ju, nuk i kalojnë 3500. Në tremujorin e parë të vitit 2022 ka pasur një rritje të numrit të vdekshmërisë prej 42%. A ka një analizë nga ISHP-ja dhe Ministria e Shëndetësisë për këto fakte? Kush mban përgjegjësi për këtë situatë? Kush e fshehu situatën reale të epidemisë në vendin tonë? Edhe pse si anëtarë të Komisionit të Shëndetësisë gjithmonë kemi mbështetur e nxitur vaksinimin e popullatës shqiptare dhe kemi qenë bashkëpunues, nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë kemi vërejtur një mungesë transparence në komunikimin tonë lidhur me këtë problem. Vaksina Covid-19 është efektive kundër varianteve të shumta dhe deri në vjeshtë është një mundësi e mirë, siç ka deklaruar pak ditë më parë shefi i Pfizer-it, Albert Bourla. Ndërsa lufta në Ukrainë largoi vëmendjen nga Covid-19, fundi i pandemisë nuk është askund në horizont, ndaj vazhdimi i kujdesit dhe vaksinimi i popullatës duhet të mbetet prioritet.

Natyrisht, ndryshimet e paraqitura në këtë akt normativ parashikojnë rishikimin e sasisë së dozave për vitin 2022. Projektligji është i shoqëruar nga dokumenti i aktit normativ, i miratuar nga Këshilli i Ministrave, i përbërë nga dy nene: në nenin e parë parashtrohet amendimi i tretë i marrëveshjes, ndërsa në nenin e dytë parashikohet “Hyrja në fuqi menjëherë në Fletoren Zyrtare”. Po ashtu, në relacionin shpjegues bashkëshoqërues, në pjesën e tretë, në argumentimin shpjegues, është parashikuar ngritja e një e grupi negociator për vlerësimin e kushteve të ndryshimit të marrëveshjes. Në pikën 1, “Sasia e furnizimit”, thuhet se kjo sasi është bazuar në përlogaritjen e kryer nga Instituti i Shëndetit Publik, por nga ISHP-ja nuk iu vu asnjë informacion me shkrim në dispozicion të Komisionit të Shëndetësisë e Mbrojtjes Sociale rreth këtij fakti. Në pikën 2, lidhur me aplikimin e vaksinës në moshën pediatrike, ende nuk kemi një vendim nga Komiteti i Etikës.

Në përkufizimin “Vaksinë pediatrike”, parashikohet se lidhur me këtë përkufizim dhe aplikimin e vaksinës në moshat pediatrike është bërë e qartë se duhet të ketë një vendim të Komitetit të Ekspertëve të Imunizimit dhe të Etikës përpara se ajo të përdoret në Shqipëri. Aktualisht, nuk jemi ende në dijeni, nëse aplikimi i vaksinimit për grupmoshën pediatrike është diskutuar nga Komiteti i Ekspertëve të Imunizimit dhe të Etikës, pra, për moshën plus 5 vjeç. Kështu që, përpara se ky vendim të merret, duhet të jetë jo vetëm konform nevojave dhe infrastrukturës së nevojshme në terren, por edhe duke marrë parasysh eksperiencën e vendeve të tjera europiane. Në këtë kontekst, nevojitet të përcaktohet se midis cilës grupmoshë parashikohet aplikimi për moshat pediatrike, nën moshën 16 vjeç, duke i ndarë më tej edhe në nëngrupe. Nëse i referohemi dy studimeve të fundit nga agjencia europiane “European Centre for Disease Prevention and Control” rezulton se aplikueshmëria e vaksinës në grupmoshën nën targetin që Shqipëria ka aplikuar, pra, plus 16 vjeç, në vendet e BE-së aplikimi në këtë moshë ndahet në dy fasha: 5 deri në 11 vjeç dhe 12-17 vjeç për adoleshentë.

Tashmë, ky rekomandim i OBSH-së duhet të jetë prioritet i Komitetit të Ekspertëve të vendit tonë. Para marrjes së vendimeve politike për vaksinimin e fëmijëve ndaj Covid-19 duhet të merren parasysh dëmet dhe përfitimet e mundshme, duke përfshirë efektet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta në shëndet dhe mirëqenie krahas përdorimit të vaksinës dhe situatës epidemiologjike në vend. Në pikën 3, “Përcaktimi i çmimit”, parashikohet se, sipas përfaqësuesit të Pfizer-it, çmimi i ofruar nga Pfizer-i është preferencial për Republikën e Shqipërisë, pasi rritja e çmimit në këtë rast vjen si rezultat i rritjes së investimeve në zinxhirin ftohës dhe rritjen e jetëgjatësisë së vaksinës. Ky parashikim mbetet i paqartë në formulim, duke qenë se nuk përcaktohet sa do të jetë vlera shtesë në kontratën e hartuar. Po ashtu, në këtë pikë nuk parashikohet se sa do jetë vlera e shtuar nga totali i vlerës së porosisë së re të dozave të vaksinave Pfizer. Dokumentacioni shpjegues nuk jep në mënyrë shteruese se pse pretendohet kjo rritje e çmimit dhe nëse kjo rritje vjen si efekt i përmirësimit të kushteve dhe infrastrukturës së menaxhimit të stokut të vaksinave, që pritet të vijnë në vitin 2022.

Në pikën 4, ku jepet përcaktimi i qartë i ndryshimeve ndërmjet termit “produkt origjinal” dhe “produkt i adaptuar”, në materialin bashkëshoqërues nuk ka shpjegim shterues se për çfarë rastesh aplikohet përcaktimi i qartë i produktit, vaksinës, si produkt origjinal apo i adaptuar. Sa i përket qëndrimit tonë, mendoj se çështjet, të cilat kërkojnë një vëmendje të veçantë janë: Së pari, cila është e ardhmja e procesit të vaksinimit, duke parë se muajt e fundit ritmi i tij është ngadalësuar së tepërmi? Shqipëria ka administruar dy milionë e tetëqind e një mijë doza vaksine, ose e thënë ndryshe, ka vaksinuar 48,9% të

popullsisë së përgjithshme, i cili është nivel i ulët krahasuar me vendet e rajonit dhe vendet europiane. Serbia ka të vaksinuar afërsisht 62% të popullatës, Greqia 96 %, ndërsa Mali i Zi 53,9% të popullatës së përgjithshme, jo popullatës target.

Nga ana tjetër, po t'u referohemi të dhënave të raportuara javën e shkuar për aplikimin ditor të vaksinave antiCovid, vihet re një numër i ulët vaksinimi, 1900- 2000 doza vakcina në ditë. Kjo do të thotë se me këtë ritëm do të na duhen edhe 298 ditë të tjera, ose 10 muaj që të rrisim me 10% nivelin e vaksinimit të popullatës sonë, në mënyrë që të kalohet pragu mbi 50%. Së dyti, lidhur me sasinë e dozave të vaksinave, që do të administrohen përgjatë vitit 2022, duke marrë parasysh numrin e ndryshuar në bazë të këtij amendimi të tretë të marrëveshjes me Pfizer, por edhe mundësinë e marrjes në dorëzim të dozave të vaksinave, që Shqipëria do të mund të marrë nga shtetet e tjera apo organizata ndërkombëtare, a e ka parashikuar Ministria e Shëndetësisë numrin e dozave që pritet të administrohen për popullatën, duke marrë parasysh faktin se parashikohet aplikimi edhe për grupmoshat pediatrike, pasi të merret miratimi nga Komiteti i Ekspertëve?

Së treti, lidhur me aplikimin e vaksinës për grupmoshat pediatrike, a ka ndërmarrë Instituti i Shëndetit Publik, apo a është në proces një studim i thelluar rreth modaliteteve dhe nevojave për grupmoshën e parashikuar, duke pasur parasysh edhe ekspertizat apo eksperiencën nga vendet e Bashkimit Europian, që tashmë e kanë aplikuar prej disa muajsh këtë vaksinë? Sipas drejtoreshës së Institutit të Shëndetit Publik vetëm 3% e fëmijëve janë prekur nga Covid-19 që nga fillimi i pandemisë. Kjo shifër tregon se te kjo grupmoshë nuk ka ende një mbrojtje imunitare natyrore. Nga Instituti i Shëndetit Publik nuk u deklarua asnjë e dhënë rreth vaksinimit të kësaj grup popullate, pra, të fëmijëve plus 12 vjeç deri tani në vend. Së fundi, në lidhje me efektet financiare shpesh, që mund të krijohen sipas materialit shpjegues të këtij projektligji, nevojitet të sqarohen në mënyrë më shteruese se pse është parashikuar kjo rritje.

Dua t'u drejtohem qytetarëve shqiptarë që të marrin të gjitha dozat e vaksinës Covid-19 të rekomanduara nga autoriteti shëndetësor sapo t'u vijë radha, duke përfshirë edhe një dozë tjetër përforcuese. Faleminderit!